



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në çështjen juridike të :

AC-I-22-0516-A0001

Paditëse/Ankuese

S B, Kralevë, Serbi, me përfaqësuese Projektin për Ndihmë Juridike, Graçanicë.

Kundër:

E paditura

N.SH N.T. "17 Nëntori" (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1903, të datës 22 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1903, i datës 22 gusht 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 30 shtator 2013, ankuesja kishte parashtruar një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr.PEJ139-0313 të datës 23 gusht 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për kompensim për paga të papaguara për periudhë dhe shumë të pacaktuar, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se AL kishte konsideruar se kërkesa është ushtruar pas afatit për parashtrimin e kërkesave.

Në ankesë theksohet se vendimi i lartcekur është i paqartë, kontradiktor dhe i pakuptimte dhe se AL ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Kushtetutën e Kosovës dhe se në përputhje me jurisprudencën e KEDNJ e drejta në pagë konsiderohet e drejtë e pronës. Tutje, ankuesja kishte pohuar se ishte diskriminuar për shkak të kombësisë së saj serbe dhe se nuk ka mundur të punoj apo të bëj padi në kuadër të N.SH-së për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë pas vitit 1999. Ankuesja i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar ashtu që të njëjtës t'i njihet e drejta në kompensim për paga të papaguara për periudhën qershor 1999 deri në privatizimin e N.SH-së në shumën prej 12,000.00 euro. Ankuesja ankesës së saj i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ139-0313 të datës 23 gusht 2013, letërnjoftimin e paditëses, kopjen e librezës së punës si dhe atë shëndetësore.

Me datë 12 prill 2018, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën theksohet se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka bërë zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura thekson se ankesa e ankueses është e pabazuar dhe se e njëjta nuk ka arritur të provoj se cila pjesë e vendimit të AL-së është e paqartë dhe as nuk ka paraqitur ndonjë argument në lidhje me këtë. Sa i përket jurisprudencës së GJEDNJ-së të cituar në ankesën e ankueses, pala kundërshtare konsideron se rrethanat e atij rasti nuk kanë asgjë të përbashkët me rrethanat e ankueses. E paditura tutje kishte theksuar se mban qëndrim të njëjtë rreth parashkrimit në përputhje me ligjin në fuqi andaj pretendimi i ankueses se është diskriminuar për shkak të përkatësisë etnike është i pabazuar dhe se vendimi i AL-së është nxjerrë në pajtim me ligjin në fuqi. E paditura gjithashtu kishte pohuar se sipas qëndrimit të vet ankueses ajo është larguar nga Kosova dhe nga vendi i saj i punës në vitin 1999 prandaj duke u bazuar në

nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, konsideron se kërkesa e ankueses është parashkuar.

Me datë 17 prill 2018 dhe 23 prill 2018 është tentuar që mbrojtja e të paditurës t'i dorëzohet ankueses, mirëpo e njëjta është kthyer me konstatimin se paditësja është zhvendosur.

Me datë 22 gusht 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1903 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se në rastin konkret nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga librezat e punës gjykata kishte gjetur se nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e N.SH-së në fjalë nga viti 1992, por gjykata kishte ardhur në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën pas muajit qershor 1999, dëshmi që ka ofruar shërbime pune për këtë periudhë. Ankuesja nuk kishte ofruar dëshmi as lidhur me shumën e as llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesja edhe vet ka pohuar se pas muajit qershor të vitit 1999 nuk ka ofruar shërbime pune për N.SH për shkak sigurie. Gjykata kishte gjetur se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, andaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara

Me datë 14 shtator 2022, ankuesja kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-1903 të datës 22 gusht 2022, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësja ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka të meta të shumta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, e posaçërisht dispozitiv i Aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në Aktgjykim, ose nuk ka fare arsye për faktet vendimtare. Tutje paditësja pretendon se Shkalla e I-rë ka qenë dashur ta anuloi vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit e jo të paraqes arsye kontradiktore për faktet vendimtare të kësaj qeshje kontestimore. Arsyet e refuzimit të kërkesës janë të pa qarta dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është e shkelur edhe e drejta materiale. Tutje paditësja pohon se Shkalla e I-rë nuk i ka marrë për bazë dispozitat materiale nga neni 221 deri 225 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësja në ankesë konsideron se me Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur të drejtat e saj të përcaktuara me nenin 24 paragrafi 2 të Kushtetutës dhe me nenin 1 protokollin 1 të Konventës Evropiane për të Drejta dhe Liri të Njeriut. Tutje ajo pohon se konstatimet e Autoritetit e Likuidimit janë të gabuara dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Në ankesë paditësja i referohet një rasti nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0151.

Me datë 26 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën e paditëses si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses për kompensim për paga të papaguara për periudhën dhe shumë të pacaktuar, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se është ushtruar pas afatit për parashtrimin e kërkesave.

Paditësja me rastin e paraqitjes së ankesës së tij në shkallë të parë i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ139-0313 të datës 23 gusht 2013, letërnjoftimin e paditëses, kopjen e librezës së punës si dhe atë shëndetësore.

Shkalla e parë e DHPGJS-së e ka trajtuar ankesën e ankueses dhe të njëjtën e kishte refuzuar si të pabazuar me arsyetimin se ankuesja nuk kishte dëshmuar të drejtën e saj mbi pagat e pretenduara me asnjë provë relevante.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së pas shqyrtimit të pretendimeve të paditëses dhe të paditurës si dhe provave në shkresa të lëndës vlerëson se shkalla e parë kishte vendosur drejtë kur kishte refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar.

Kolegji i Apelit konsideron se paditësja me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se AKP-ja i ka borxh shumën e pretenduar. E njëjta përveç që ka dorëzuar kopjen e librezës së punës e cila rezulton si e hapur si dhe atë shëndetësore si dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, në rastin konkret nuk ka specifikuar ose provuar se sa ka qenë lartësia e pagës që ajo e ka marrë në baza mujore, ose nuk ka dorëzuar ndonjë provë si lista e pagave që ndërmarja në fjalë mund t'i ketë mbetur borxh paditëses, në mënyrë që t'i mbështetë pretendimet e saj dhe t'i njihet e drejta në kompensimin e shumës së lartcekur.

Barra e provës sipas nenit 42.2 të ligjit për DHPGJS-së për të vërtetuar këtë fakt bie mbi paditësen. E njëjta përkundër provave të lartcekura të cilat ndodhen në shkresa të lëndës, nuk ka vërtetuar faktin se N.SH-ja i ka mbetur borxh shumën për periudhën dhe shumën e pretenduar.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses, pasi që të njëjtës në mungesë të provave nuk mund t'i njihet e drejta në kompensim të shumës së pretenduar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja në bazë të nenit 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është e liruar nga pagesa e taksës gjyqësore pasi që e njëjta ka dëshmuar se është duke marrë ndihmë nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 4 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues _____